Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aseti në kompetencat administrative të Agjencisë.


Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/25

Në bazë të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe bazuar në Rregulloren nr. 6/2023 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve transaksioneve të Ndërmarrjeve Shoqërore ShAL 69, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet shitja e Njesisë nr. 52 - NSh DLB-Parcela 285-0 ZK Dushanovë Prizren me ofertues me çmim 36,100 €.
- II. Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së që asetin t'a tenderojë sërish në një fazë të mëvonshme sipas planit dinamik të Menaxhmentit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për transaksionet e ShAL 69.

Duke qenë se Bordi konsideron se kjo pronë klasifikohet si pronë rezidenciale dhe ka çmim orientues 8,000 €/ari (tenderimi i tretë - minus 20 % çmimi rezulton 6,400 €/ari) dhe duke qenë se ofertuesi ka ofruar 2,537 €/ari - bazuar në Nenin 14.3.1 të Rregullave të Tenderit, pasi që çmimi i pranuar është më i ultë se çmimi orientues, është refuzuar shitja e këtij aseti.

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aseti në kompetencat administrative të Agjencisë.

Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/26

Në bazë të neneve 15.2.15 dhe 20.2 të Ligjit nr. 04/L-034 të Agjencisë (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), bazuar në përgjegjësitë e përgjithshme të Bordit të Drejtorëve, si dhe nenit 43.4 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Plani Vjetor i Punës dhe Performancës i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2025.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe aprovoj sipas procedurave Plani Vjetor të Punës dhe Performancës i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2025. Plani është në pajtueshmëri me qëllimet dhe planet e Agjencisë të përcaktuara në kornizën ligjore të AKP-së si dhe kërkesat e Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura.


Gjithashtu, ky plan është hartuar në përputhje me Strategjinë Përmbyllëse të AKP-së dhe paraqet objektivat kryesore, prioritetet dhe fushëveprimin e aktiviteteve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2025.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/27

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores nr. 03/2024 angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet shmangia e Rregullores nr. 03/2024 për angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH), përkatësisht nenit 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9 dhe nenit 11 të kësaj Rregulloreje;
- II. Miratohet Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit për financimin e Ofruesve të Shërbimeve për nevojat e administratës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- III. Autorizohet Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencisë për financimin e Ofruesve të Shërbimeve për nevojat e administratës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (OSH),

Ky vendim merret me qëllim të rritjes së bashkëpunimit në mes të AKP dhe KGJK është konsideruar nga dy institucionet si e domosdoshme vazhdimi edhe për një (1) vit i këtij memorandumi të mirëkuptimit. Qëllimi i këtij memorandumi është rritja e efikasitetit, transparencës, ekonomizimit të procedurave, përshpejtimin të proceseve të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe në përgjithësi ndihmës së ndërsjellë në mes të AKP dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës i cili parashihet të arrihet me angazhimin e njëzet (20) Ofruesve të Shërbimeve/Juristëve të diplomuar, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me procedurën e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, prej tyre një (1) Ofrues i Shërbimeve duhet të jetë i angazhuar vetëm për kërkesat nga AKP lidhur me dërgimin e informatave të nevojshme për lëndet e ankesave aktive ndaj NSH-ve.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024

Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/28

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e palës parashtrues i kërkesës: _____ (trashëgimtar ligjor), ku bartës i të drejtës banesore është _____ (i ndjerë), me numër KB-1804 përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 15.11.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH IMN Kosova, Prishtinë (PRN029).
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 15.11.2024 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e palës parashtrues i kërkesës: _____ (trashëgimtar ligjor), ku bartës i të drejtës banesore është _____ (i ndjerë) për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga IMN Kosova, Prishtinë (PRN029). Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024


Mentor Hyçeni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/29

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e palës (trashëgimtar ligjor), ku bartësi i së drejtës banesore është (tani i ndjerë) me numër KB-1684/22 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 15.11.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh Ramiz Sadiku-Prizren (PRZ017).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 15.11.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës (trashëgimtar ligjor), ku bartësi i së drejtës banesore është (tani i ndjerë) për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh Ramiz Sadiku-Prizren (PRZ017). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palëve janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se pala nuk posedon Kontratën mbi shfrytëzimin e banesës. Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/30

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e palës _____ me numër KB-1443/17 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 15.11.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH DD Juko Dubrava, Istog (PEJ036).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 15.11.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës _____ për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH DD Juko Dubrava, Istog (PEJ036). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si “Ligji për Shitjen e Banesave”) lidhur me kërkesën e palëve janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjetë se pala nuk posedon Vendim mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim dhe Kontrata mbi shfrytëzimin e banesës. Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/31

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e palës me numër KB-1806/24 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 15.11.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH Banesa -BVI për Banim -Prizren (PRZ055).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 15.11.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH Banesa - BVI për Banim -Prizren (PRZ055). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palëve janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se pala nuk posedon Vendimi për ndarjen e banesës në shfrytëzim dhe Kontratën mbi shfrytëzimin e banesës. Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3; paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/32

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e palës _____ me numër KB-1667/22 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 15.11.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Printex", Prizren (PRZ036).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 15.11.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës _____ për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Printex", Prizren (PRZ036). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palëve janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjijtje të kërkesës dhe gjeti se pala nuk posedon Vendim mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim dhe Kontrata mbi shfrytëzimin e banesës, dhe nga përgjigja e Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës kërkesa e palës ne fjale me Vendim HPCC/D/195/2005/A&C i datës 18.05.2005 vendos që kërkesa e z. _____ është refuzuar, andaj Komisioni konstaton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenit 1, nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86), si dhe nenin 13, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-061, për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e Drejta Banesore. Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/33

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e palëve dhe me numër KB-1142/14 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 15.11.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Stan" Prizren (PRN055).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 15.11.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palëve dhe për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Stan" Prizren (PRN055). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palëve janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se palët nuk posedojnë Vendimin për ndarjen e banesës në shfrytëzim dhe Kontratën mbi shfrytëzimin e banesës, pasi që parashtruesit e kërkesave nuk kanë arritur të argumentojnë me anë të provave se janë bartësit të së drejtës banesore edhe pas dërgimit të kërkesës për dokumente shtesë nga Komisioni, Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/34

Në bazë të neneve 14.10 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 13.1 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me këtë konfirmon dhe njeh si të vetin, vendimin Nr. Ref. BD-215/1 të datës 22 nëntor 2024 të nënshkruar nga Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesja e Bordit, dhe efekti i të cilit vendim rrjedh nga data e nënshkrimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Me datën 22 nëntor 2024 Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesja e Bordit kishin nënshkruar vendimin Nr. Ref. BD-215/1 për dy aseteve nga SHAL 70 sipas kërkesës së Komunës së Gjakovës, pra Njësia nr.01 - Motel Drini i Bardhë dhe Njësia nr.02-Lokali në Rr.Musa Zajmi, Gjakovë.

Arsyeja pse Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesja kanë marrë këtë vendim emergjent, qëndron në faktin se data kur është marrë ky vendim nuk ka qenë objektivist e mundur që të mblidhet Bordin për të shqyrtuar dhe marrë këtë vendim, apo që një gjë e tillë të bëhet përmes procedurës me shkrim.

Sa i përket çështjes për të cilën vendimi është marrë, gjegjësisht kërkesës së Komunës së Gjakovës për heqjen e dy aseteve në Gjakovë nga SHAL 70. Shpallja e SHAL 70 është aprovuar nga Bordin me datë 30.10.2024, dhe para shpalljes për publikun janë njoftuar komunat sipas afateve ligjore nëse kanë ndonjë interes për ndonjë aset. SHAL 70 është shpallur për publikun më datë 07.11.2024. Komuna e Gjakovës me datë 19.11.2024 ka dërguar shkresë ku ka kërkuar që të largohen asete 1 dhe 2 të SHAL 70 për shkak se kanë iniciuar shpronësimin e tyre. Menaxhmenti kishte paraqitur memorandumën me arsyetimet përkatëse para marrjes së këtij vendimi i cili është i bashkangjitur me këtë memorandum. Në mënyrë që të njoftohen palët paraprakisht për tërheqjen e këtyre aseteve nga shitja dhe pasi që mbledhja e rregullt e Bordit është me të njëjtën datë 27.11.2024 kur është edhe dita e shitjes dhe për arsye se është në fjala për interesi publik u marrë vendimi emergjent me datë 22 nëntor 2024.


Andaj duke pas parasysh atë që u tha më lartë Bordin shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/35

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Nenit 127 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet Detyrimore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprobohet nënshkrimi i kontratës së qirasë për depon me sipërfaqe prej 300 m², pronë e NSh Jatex, në emër të kompanisë “Perfeco Inc” sh.p.k, përfaqësuar nga Driton Pozhegu i cili është ofertues fitues i tenderit të datës 18 tetor 2024 si dhe vendimit të Bordit Nr. Ref.BD-213/12 i datës 30 tetor 2024.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qirasë direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Me datë 4 tetor 2024, është bërë shpallja në mjete publike informimi për qiradhënie të asetit të Ndërmarrjes Jatex. Sipas vendimit nr. DE 435-2024 të datës 17.10.2024, të lëshuar nga Drejtori Ekzekutiv i AKP-së ZQ Prishtinë, është formuar komisioni i cili ka pas për detyrë hapjen dhe vlerësimin e ofertave. Data e prezantimit të ofertave ka qenë me date 18.10.2024 në Zyrën Qendrore të AKP-se në Prishtinë. Komisioni/Menaxhmenti ka rekomanduar aprovimin e ofertës për qiradhënie të asetit/depo në sipërfaqe prej 300 m², ofertuesit me ofertën më të lartë z. Driton Pozhegu, të cilën Bordi me datë 30 tetor 2024 e ka aprovuar përmes vendimit Nr. Ref. BD-213/12 për dhënie me qira të depos në sipërfaqe prej 300 m² me ofertues Driton Pozhegu, me vlerën me të lartë në vlerë prej 412.00€/muaj.


Me datë 6 Nëntor 2024 Bordi i Përkohshëm Menaxhues i NSh Jatex ka pranuar kërkesën nga qiramarrësi i depos Driton Pozhegu, që kontrata e qirasë të nënshkruhet në emër të subjektit “Perfeco Inc” sh.p.k. me numër të biznesit 812216069 përfaqësuar nga Driton Pozhegu. Bordi i ndërmarrjes e ka aprovuar këtë kërkesë. Poashtu edhe Menaxhmenti i Agjencisë ka propozuar aprovimin e kësaj kërkesë.

Duke ju referuar dokumentacionit të prezantuar si Certifikatën e biznesit me informata të biznesit, parashtruesi i kësaj kërkesë gjegjësisht fituesi i tenderit Driton Pozhegu, është përfaqësues i subjektit “Perfeco Inc” sh.p.k. me numër të biznesit 812216069 e cila dëshmohet me certifikatë biznesi dhe verifikim nga ARBK.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 27 nëntor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/36

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë të nënshkuara në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSH "Tregu" dhe parashtruesve të këtyre kërkesave, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratave të qirasë tek NSH Tregu:
- a) Nga Fatlum Krasniqi si qiramarrës i pjesës së tokës afariste e identifikuar me nr.91B në sipërfaqe prej 29m2, e cila ndodhet në Tregun me Shumicë tek "N.T. Fatlumi" në shumën prej 107.00 Euro/muaj;
 - b) Nga Ruzhdi Gashi si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr.280, 281 me sipërfaqe prej 28 m2 në Tregun te ish-Amortizatorët tek "Sport Shop te Tefiku & Ruzhda" në shumën prej 80.00 Euro/muaj;
 - c) Nga Sylejman Kastrati si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr.176 me sipërfaqe nuk aplikohet m2 në Tregun te ish-Amortizatorët tek "Faton Nishevc" në shumën prej 90.00 Euro/muaj;
 - d) Nga Astrit Kastrati si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr.177 me sipërfaqe nuk aplikohet m2 në Tregun te ish-Amortizatorët tek "Faton Nishevc" në shumën prej 90.00 Euro/muaj;
- II. Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë të transferuara tek personat e lartcekur dhe ndërrimit të emrit, Qiramarrësit aktual do të jenë të obliguar të paguajnë borxhin e papaguar, ose në të kundërtën do të ndermirën të gjitha veprimet ligjore për inkasimin e borxhit të papaguar dhe lirim të hapësirave:
- a) Qiramarrësi Fatlum Krasniqi si qiramarrës i pjesës së tokës afariste 91B me sipërfaqe prej 29m2 tek Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek "N.T. Fatlumi" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 98.84€ Euro;
 - b) Qiramarrësi Ruzhdi Gashi si qiramarrës i pjesës së tokës afariste 280, 281 me sipërfaqe prej 28m2 tek Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek "Sport Shop Te Tefiku & Ruzhda" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 777.86€ Euro;
 - c) Qiramarrësi Sylejman Kastrati si qiramarrës i pjesës së tokës afariste 176 me sipërfaqe nuk aplikohet m2 tek Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek "Faton Nishevc" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 166.28€ Euro;
 - d) Qiramarrësi Astrit Kastrati si qiramarrës i pjesës së tokës afariste 177 me sipërfaqe nuk aplikohet m2 tek Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek "Faton Nishevc" është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 166.28€ Euro;
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

M.H.



Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

1. Me datë 15/10/2024 Agjencia ka pranuar kërkesë të parashtruar nga z. Fatlum Krasniqi shfrytëzues i hapësirës afariste 91/B NSH Tregu, i regjistruar në MTI-ARBK me NUI:811353698 ka kërkuar nga AKP/AL ndryshim të emrit nga Fatlum Krasniqi (kontratë mbi qiranë me nr.prot. 52923/2024 – Toka Afariste me nr. 91/B) në emër të N.T. Fatlumi.
2. Me datë 18/11/2024 Agjencia ka pranuar kërkesë të parashtruar nga z. Ruzhdi Gashi shfrytëzues i hapësirës afariste nr. 280-281 duke kërkuar nga AKP/AL ndryshim të emrit nga Ruzhdi Gashi (kontratë mbi qiranë me nr.prot. 2147/2015 – Toka Afariste nr.280, 281) në emër të “Sport Shop te Tefiku & Ruzhda” me NUI: 810940404.
3. Me datë 12/11/2024 Agjencia ka pranuar kërkesë të parashtruar nga z. Sylejman Kastrati shfrytëzues i hapësirës afariste nr. 176 duke kërkuar nga AKP/AL ndryshim të emrit nga Sylejman Kastrati (kontratë mbi qiranë me nr.prot. 5392/2015 – Toka Afariste nr.176) në emër të “Faton Nishevei”.
4. Me datë 12/11/2024 Agjencia ka pranuar kërkesë të parashtruar nga z. Astrit Kastrati shfrytëzues i hapësirës afariste nr. 177 duke kërkuar nga AKP/AL ndryshim të emrit nga Astrit Kastrati (kontratë mbi qiranë me nr.prot. 5428/2015 – Toka Afariste nr.177) në emër të Faton Nishevei.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratave të Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Poashtu aprovimi i transferimit të kontratave të qirasë do të fillonte në zvogëlimin e problemeve tek NSH Tregu, sidomos sa i përket pjesës së lidhjes së kontratave dhe identifikimit të saktë të qiramarrësve të pjesëve të caktuara të tokës afariste.

Qiramarrësi Fatlum Krasniqi për tokën afariste nr. 91B tek Tregu me Shumicë, në sipërfaqe prej 29m2 ka borxh të paguar në shumën prej 98.84 Euro.

Qiramarrësi Ruzhdi Gashi për tokën afariste nr. 280, 281 tek Tregu me Shumicë, në sipërfaqe prej 28m2 ka borxh të paguar në shumën prej 777.86 Euro.

Qiramarrësi Sylejman Kastrati për tokën afariste nr. 176 tek Tregu me Shumicë, në sipërfaqe nuk aplikohet m2 ka borxh të paguar në shumën prej 646.53 Euro.

Qiramarrësi Astrit Kastrati për tokën afariste nr. 177 tek Tregu me Shumicë, në sipërfaqe nuk aplikohet m2 ka parapaguar qiranë në shumën prej -364.86 Euro.

Para nënshkrimit të kontratave të transferuara tek personat tek të cilët do të transferohen të kërkohet nga secili qiramarrës që të paguajë borxh e paguar, në të kundërtën kontratat e transferuara nuk do të nënshkruhen dhe do të kërkohet që parashtruesit e kërkesave të lirojë hapësirën/pjesëve të tokave afariste specifike. dhe për borxhin e paguar do të ndërmerren veprime ligjore.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/37

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Nenit 10.1.5 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neneve 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimimin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të:

- a) Tokë Afariste me sipërfaqe 136.00m², ku është e vendosur depo me material të vrazhdë nr.15/A - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 266.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Burim Sfishta;
- b) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.99 me sipërfaqe të përgjithshme prej 67.00m²-Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 131.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Nazmi Aliu ;
- c) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.101 me sipërfaqe të përgjithshme prej 42.00m² Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 82.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Bajram Stublla ;
- d) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me material të vrazhdë nr.11/A me një sipërfaqe të përgjithshme prej 72.00m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 141.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Xhemajl Radosta;
- e) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.100 me një sipërfaqe të përgjithshme prej 121.00m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 236.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Luan Ymeri ;
- f) Tokë afariste nr.170 në të cilën është e vendosur lokali me material të vrazhdë (pikë shitëse) me një sipërfaqe të përgjithshme prej 112.07m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 424 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Bedri Vitija;
- g) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me material të vrazhdë nr.13/A me një sipërfaqe të përgjithshme prej 237.00m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 463.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Albert Rudari ;
- h) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.59 dhe 60 me një sipërfaqe të përgjithshme prej 250.18m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 489.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Oskar-A SH.P.K përfaqësuar nga Berat Kaçiu ;
- i) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me material të vrazhdë nr.10A me një sipërfaqe të përgjithshme prej 76.00m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 149.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Florent Potera ;



- j) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.74 me sipërfaqe të përgjithshme prej 78.00m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 205.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Avdi Jashari;
- k) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 420, 421, 453, 454, 455 me sipërfaqe të përgjithshme prej 66.00m² dhe tokë afariste nr.417,418 dhe 419 me sipërfaqe prej 39m²- Tregu me Shumicë (Zona Industriale) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 152.00€ për një muaj për parashtruesin e kërkesës Bedri Duriqi;
- II. Para lidhjes së marrdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimim e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive parashtruesit e kërkesave para nënshkrimit të kontratave të qirasë do të duhet të paguajnë shumat si në vijim:
- a) Tokë Afariste me sipërfaqe 136.00m², ku është e vendosur depo me material të vrazhdë nr.15/A - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) parashtruesi i kërkesës Burim Sfishta duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 5 muaj (Korrik, Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor) e kaluara shumë prej 1,330.00 € - respektivisht (266€/5 muaj).
- b) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.99 me sipërfaqe të përgjithshme prej 67.00m²-Tregu me Shumicë (Zona Industriale) parashtruesi i kërkesës Nazmi Aliu duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 3 muaj (Shtator, Tetor dhe Nëntor) e kaluara shumë prej 393 € - respektivisht (131€/3 muaj).
- c) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.101 me sipërfaqe të përgjithshme prej 42.00m² Tregu me Shumicë (Zona Industriale) parashtruesi i kërkesës Bajram Stublla duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 3 muaj (Shtator, Tetor dhe Nëntor) e kaluara shumë prej 246 € - respektivisht (82€/3 muaj).
- d) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me material të vrazhdë nr.11/A me një sipërfaqe të përgjithshme prej 72.00m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) parashtruesi i kërkesës Xhemajl Radosta duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muaj (Tetor dhe Nëntor) e kaluara shumë prej 282 € - respektivisht (141€/2 muaj)
- e) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.100 me një sipërfaqe të përgjithshme prej 121.00m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) parashtruesi i kërkesës Luan Ymeri duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 3 muaj (Shtator, Tetor dhe Nëntor) e kaluara shumë prej 708 € - respektivisht (236€/3 muaj).
- f) Tokë afariste nr.170 në të cilën është e vendosur lokali me material të vrazhdë (pikë shitëse) me një sipërfaqe të përgjithshme prej 112.07m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) parashtruesi i kërkesës Bedri Vitija duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 5 muaj (Korrik, Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor) e kaluara shumë prej 2120 € - respektivisht (424€/5 muaj)
- g) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me material të vrazhdë nr.13/A me një sipërfaqe të përgjithshme prej 237.00m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) parashtruesi i kërkesës Albert Rudari duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muaj (Tetor dhe Nëntor) e kaluara shumë prej 926€ - respektivisht (463€/2 muaj);
- h) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.59 dhe 60 me një sipërfaqe të përgjithshme prej 250.18m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) për parashtruesi i kërkesës Oskar-A SH.P.K përfaqësuar nga Berat Kaçiu duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muaj (Tetor dhe Nëntor) e kaluara shumë prej 978€ - respektivisht (489€/2 muaj);
- i) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo me material të vrazhdë nr.10A me një sipërfaqe të përgjithshme prej 76.00m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) parashtruesi i kërkesës



- Florent Potera duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 4 muaj (Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor) e kaluara shumë prej 596€ - respektivisht (149€/4 muaj)
- j) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.74 me sipërfaqe të përgjithshme prej 78.00m² - Tregu me Shumicë (Zona Industriale) parashtruesi i kërkesës Avdi Jashari duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 4 muaj (Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor) e kaluara shumë prej 608€ - respektivisht (152€/4 muaj);
- k) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 420, 421, 453, 454, 455 me sipërfaqe të përgjithshme prej 66.00m² dhe tokë afariste nr.417,418 dhe 419 me sipërfaqe prej 39m²- Tregu me Shumicë (Zona Industriale) parashtruesi i kërkesës Bedri Duriqi duhet të paguaj retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 4 muaj (Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor) e kaluara shumë prej 820€ - respektivisht (205€/4 muaj);

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qirave sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Me datë 15.11.2024 Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë, ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25760/2024, të parashtruar nga Burim Sfishta ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.15 A që menaxhohet nga NSH Tregu dhe ndodhet në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Për tokën ku është e vendosur depo me material të vrazhdë nr.15/A është paraparë çmimi prej 266.00€/muaj. Si rrjedhojë, qiramarrësi para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të jetë i obliguar të paguajë shumë prej 1,330€ (Korrik, Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor (5 muaj) x 266.00 € = 1330€). Pala nuk figuron të ketë pasur kontratë aktive me AKP/AL e NSH Tregu (PRN104). Kjo hapësirë afariste në bazë të informatave nuk është shfrytëzuar asnjëherë më parë deri sa është hapur në muajin korrik 2024 nga kjo palë dhe nuk dihet se kush ka qenë pronari i depos që nga fillimi i periudhave të funksionimit të Tregut në atë zonë.

Me datë 20.09.2024 Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë, ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25398/2024, të parashtruar nga Nazmi Aliu, ku është kërkuar të marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.99 e cila menaxhohet nga NSH Tregu, dhe ndodhet në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale Prishtinë. Për tokën ku janë të vendosura depo e konstruksionit metalik është paraparë çmimi prej 131.00€/muaj. Si rrjedhojë, qiramarrësi para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të jetë i obliguar të paguajë shumë prej 393.00€ (Shtator, Tetor dhe Nëntor (3 muaj) x 131.00€ = 393.00 €). Pala nuk figuron të ketë pasur kontratë aktive me AKP/AL e NSH Tregu (PRN104). Kjo hapësirë afariste në bazë të informatave nuk është shfrytëzuar asnjëherë më parë deri në paraqitjen e kësaj kërkesë.

Me datë 20.09.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25429/2024, të parashtruar nga Bajram Stublla, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.101, që menaxhohet nga NSH Tregu dhe ndodhet në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë. Për tokën ku ndodhen depo e konstruksionit metalik nr.101 është paraparë çmimi prej 82€/muaj. Si rrjedhojë, qiramarrësi para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të jetë i obliguar të paguajë shumë prej 246.00€ (Shtator, Tetor dhe Nëntor (3 muaj) x 82.00 € = 246.00 €). Pala nuk figuron të ketë pasur kontratë aktive me AKP/AL e NSH Tregu (PRN104). Kjo hapësirë afariste në bazë të informatave nuk është shfrytëzuar asnjëherë më parë deri në paraqitjen e kësaj kërkesë.

Me datë 06.11.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25679/2024, të parashtruar nga Xhemajl Radosta, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.11/A, që menaxhohet nga NSH Tregu dhe ndodhet në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.



Për hapësirën afariste/tokën ku ndodhen depo me material të vrazhdë nr.11/A është paraparë çmimi prej 141€/muaj. Si rrjedhojë, qiramarrësi para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 282.00€ (Tetor dhe Nëntor (2 muaj) x 141.00 € = 282.00 €).

Me datë 06.11.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25683/2024, të parashtruar nga Luan Ymeri, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.100, që menaxhohen nga NSH Tregu dhe ndodhet në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Për tokën ku janë te vendosura depo e konstruksionit metalik nr.100 është paraparë çmimi prej 236€/muaj. Si rrjedhojë, qiramarrësi para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 708€ (Shtator, Tetor dhe Nëntor (3 muaj) x 236.00 € = 708€). Pala nuk figuron të ketë pasur kontratë aktive me AKP/AL e NSH Tregu (PRN104). Kjo hapësirë afariste në bazë të informatave nuk është shfrytëzuar asnjëherë më parë deri në paraqitjen e kësaj kërkesë.

Me datë 06.11.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25687/2024, të parashtruar nga Bedri Vitija, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.170, që menaxhohen nga NSH Tregu dhe ndodhet në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Për tokën ku janë të vendosura lokali me material të vrazhdë (pikë shitëse) është paraparë çmimi prej 424.00€/muaj. Si rrjedhojë, qiramarrësi para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 2120€ (Korrik, Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor (5 muaj) x 424.00€ = 2120 €). Pala nuk figuron të ketë pasur kontratë aktive me AKP/AL e NSH Tregu (PRN104). Kjo hapësirë afariste në bazë të informatave nuk është shfrytëzuar asnjëherë më parë deri në paraqitjen e kësaj kërkesë.

Me datë 06.11.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25689/2024, të parashtruar nga Albert Rudari, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.13/A, që menaxhohen nga NSH Tregu dhe ndodhet në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Për tokën ku ndodhen depo me material të vrazhdë nr.13/A është paraparë çmimi prej 463.00€/muaj. Si rrjedhojë, qiramarrësi para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 926€ (Tetor dhe Nëntor (2 muaj) x 463.00€ = 926€). Pala nuk figuron të ketë pasur kontratë aktive me AKP/AL e NSH Tregu (PRN104). Kjo hapësirë afariste në bazë të informatave nuk është shfrytëzuar asnjëherë më parë deri në paraqitjen e kësaj kërkesë.

Me datë 15.11.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25757/2024, të parashtruar nga kompania Oskar-A SH.P.K përfaqësuar nga Berat Kaçiu, ku është kërkuar marrja me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.59 dhe 60, që menaxhohen nga NSH Tregu dhe ndodhen në Tregun me Shumicë (Pemë-Perime) – Zona Industriale, Prishtinë.

Për hapësirën afariste/tokën ku ndodhen depo e konstruksionit metalik nr.59 dhe 60 është paraparë çmimi prej 489€/muaj. Si rrjedhojë, qiramarrësi para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 978€ (2 Tetor dhe Nëntor (2 muaj) x 489.00 € = 978€). Pala nuk figuron të ketë pasur kontratë aktive me AKP/AL e NSH Tregu (PRN104). Kjo hapësirë afariste në bazë të informatave nuk është shfrytëzuar asnjëherë më parë deri në paraqitjen e kësaj kërkesë.

Me datë 15.11.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25758/2024, të parashtruar nga Florent Potera, ku është kërkuar marrja me qira përmes procedurës së qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.10/A. Kjo hapësirë është nën menaxhimin e NSH Tregu dhe ndodhet në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Për tokën ku është e vendosur depo me material të vrazhdë nr.10/A është paraparë çmimi prej 149€/muaj. Si rrjedhojë, qiramarrësi para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 596.00€ (Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor (4 muaj) x 149.00 € = 596.00 €). Pala nuk figuron të ketë pasur kontratë aktive me AKP/AL e NSH Tregu (PRN104). Kjo hapësirë afariste në bazë të informatave nuk është shfrytëzuar asnjëherë më parë deri në paraqitjen e kësaj kërkesë.

Me datë 15.11.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 25759/2024, të parashtruar nga Avdi Jashari, ku është kërkuar marrja me qira përmes procedurës së qiradhënies direkte të



hapësirës afariste/tokës nr.74. Kjo hapësirë është nën menaxhimin e NSH Tregu dhe ndodhet në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Për tokën ku është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.74 është paraparë çmimi prej 152€/muaj. Si rrjedhojë, qiramarrësi para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 608.00€ (Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor (4 muaj) x 152.00 € = 608.00 €). Pala nuk figuron të ketë pasur kontratë aktive me AKP/AL e NSH Tregu (PRN104). Kjo hapësirë afariste në bazë të informatave nuk është shfrytëzuar asnjëherë më parë deri në paraqitjen e kësaj kërkesë.

Me datë 20.11.2024, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokolli 25769/2024 dhe 25770/2024, të parashtruar nga Bedri Duriqi, ku është kërkuar marrja me qira përmes procedurës së qiradhënies direkte të hapësirës afariste/tokës nr.417,418,419,420,421,453,454 dhe 455. Kjo hapësirë është nën menaxhimin e NSH Tregu dhe ndodhen në Tregun me Shumicë (Tekstil) – Zona Industriale, Prishtinë.

Për tokën ku është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr.417,418,419,420,421,453,454 dhe 455 është paraparë çmimi prej 205€/muaj. Si rrjedhojë, qiramarrësi para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 820.00€ (Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor (4 muaj) x 205.00 € = 820.00 €). Pala nuk figuron të ketë pasur kontratë aktive me AKP/AL e NSH Tregu (PRN104). Kjo hapësirë afariste në bazë të informatave nuk është shfrytëzuar asnjëherë më parë deri në paraqitjen e kësaj kërkesë.

Këto hapësira nuk janë në listën e asetve të cilat i janë propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me strategjinë për krijimin e Fondit Sovran.


Më parë këto hapësira nuk janë tenderuar ndonjëherë për qiradhënie publike për arsye se NSH Tregu dhe asetet e saja janë me karakter specifik. Kontratat e qirasë do të lidhen me efekt nga data 01.12.2024.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/38

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 3 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 3.10.1 të Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, nenit 11 par. 1 i Kontratës së Qirasë out-35378/16 e datës 20.12.2016; nenit 590 par. 1 dhe 595 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për aprovim/korrigjim të vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. BD-175/16 të datës 27.01.2023 në raport me çmimin vlerësues për njësinë nr. 62 , e cila nga çmimi sa kishte në 350.00 €/muaj të rritet në çmimin prej 479.00 €/muaj.
- II. Obligohet pala që para nënshkrimit të vazhdimit të kontratës së qirasë të paguajë për periudhën mars 2024 – nëntor 2024 shumën e qirasë prej 479.00 €/muaj apo totalin prej 941.23 €. Në rast se pala nuk e paguan çmimin e lartëcekur atëherë do të jetë e obliguar të lirojë asetin dhe të kompensojë Autoritetin e Likuidimit të NSh “Lavërtari Blegtori” për periudhën e lartëcekur.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit përmes të cilit kërkohet ndryshimi i vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. BD-175/16 të datës 27.01.2023, saktësisht korrigjimi i vendimit kërkohet të bëhet vetëm në raport me çmimin vlerësues për njësinë nr. 62.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se

NTSH €-Loni përfaqësuar nga Shkelzen Gashi (tani e tutje ‘pala’) ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë më datë 20.12.2016 në bazë të kontratës së qirasë me nr. protokollit OUT-35378/16 për ngastrat kadastrale 00187-1 dhe 00188-2 ZK Dushanovë në sipërfaqe prej 20000 m² për shumën prej 350.00 €/muaj. Me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-175/16 të datës 27.01.2023 është bërë rivlerësimi i kësaj kontrate të qirasë dhe nga shuma prej 350.00 € është vendosur që për pagesë të jetë shuma prej 1445.00 €/muaj. Më datë 20.02.2023, Autoriteti i Likuidimit i ka dërguar shkresë palës ku e ka njoftuar me rivlerësimin e vlerës së qirasë sipas vendimit të Bordit. Pala është përgjigjur në shkresë më datë 28.02.2023 me nr. protokollit IN-22343 ku ka theksuar që do ta nënshkruajnë këtë aneks kontratë me çmim të rritur dhe do ta kundërshtojnë vendimin e Bordit. Këtë e ri-theksojnë edhe në shkresën e datës 08.11.2024 ku sqarojnë se nënshkrimin e kanë bërë për shkak se nga frika se mos vendoset në tender publik dhe se ende nuk ishin pajisur me vendimin e Bordit.

Aneksi i fundit i kontratës së qirasë është nënshkruar më datë 02.03.2023 në shumën prej 1,445.00 €.

Pala ka parashtruar padë me propozim për masë të përkohshme në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (tani e tutje DhPGJS). DhPGJS ka nxjerrur aktvendimin C-I-23-0011 me të cilin ka caktuar masën e sigurimit dhe pezullohet zbatimi i vendimit të AKP-së Nr. Ref. BD-175/16 të datës 27.01.2023 ndaj propozuesit deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Po ashtu, masa e sigurisë është lënë në fuqi edhe me Aktvendimin AC-I-23-0194 të datës 10 maj 2023 duke vërtetuar Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar.



Ndër arsyetimet e DhPGjS janë paraqitur fakti që vendimi i Bordit i referohet një rritje prej 30% ndërsa rritja arrin deri në vlerën 400%. Gjithashtu, DhPGjS ka marrë parasysh edhe shkallën e rrezikshmërisë së funksionimit të biznesit të qiramarrësit, ku me rritjen e tillë konsiderohet se do të i shkaktohej dëm dhe kompensimi do të ishte i pamundur.

Pas kësaj, pala ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të Rivlerësimit të Qirasë për tokën komerciale me nr. protokollit 1676 të datës 26.04.2024.

Më datë 23.07.2024, AL i ka kthyer përgjigje palës nr. prot. 49260 ku i është përgjigjur duke i thënë se është në vullnetin e palëve që të lidhin marrëveshje dhe se i është kërkuar të nënshkruajë kontratën konform vendimit të Bordit

Më datë 06.08.2024 pala është përgjigjur në përgjigjen e AL-së duke sqaruar dhe pretenduar se nuk po veprojmë konform Ligjit dhe vendimeve të DhPGjS dhe se si rrjedhojë po kryhet vepër penale për mos zbatim të vendimeve të DhPGjS, gjë të cilën e ka cekur edhe në kërkesën e fundit të datës 08.11.2024.

Aneksi i fundit i kontratës së qirasë është nënshkruar më datë 02.03.2023 dhe ka skaduar me datë 28.02.2024 dhe nuk ka pranuar të nënshkruajë prapë kontratë të qirasë.

Nga marsi 2024 deri më tani ka borxh total prej 8,934.00 deri më tani, borxh i cili i përket vetëm kësaj periudhe. Pala edhe përkundër faktit që nuk ka pasur kontratë të qirasë, ai nga marsi 2024 është faturuar me shumën prej 1,445.00 €. Në bazë të deklarimeve të ZR Prizren, pala kohë pas kohe ka kryer pagesa vazhdimisht.

Pala në kërkesën e datës 08.11.2024 është zotuar se do të bëjë tërheqjen e padisë dhe kërkon që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje dhe këtë gjë e vlerëson edhe Agjencia dhe konstaton se një zgjidhje me marrëveshje nuk do të dëmtonte asnjërin prej palëve.

Në bazë të raportit të vlerësimit nga ana e Komisionit Vlerësues është përcaktuar shuma prej 479.00 € për muaj, duke marrë për bazë faktin se prona nuk shfrytëzohet në tërë potencialin komercial të saj për arsye se nuk ka të vendosur ndonjë objekt dhe zhvillohet aktivitete të tregut të kafshëve vetëm një herë në javë (ditën e mërkurë).

Po ashtu, për periudhën mars 2024 – nëntor 2024 palës i kërkohet të paguajë çmimin e rivlerësuar prej 479.00 € për çdo muaj nga marsi 2024. Nga borxhi total prej 8,934.00 (neto) € nëse do të faturohej në shumën prej 1,445.00, palës duke ju llogaritur nga marsi 2024 shuma prej 479.00 € në bazë të rivlerësimit, atëherë borxhi total i bie të jetë 941.23 € (Neto) (mars-nëntor 2024, duke përfshirë edhe parapagimin që ka bërë) borxh të cilit do të jetë i obliguar ta paguajë para nënshkrimit të kontratës së qirasë.


Duke u bazuar në aktgjykimet C-I-23-0011 dhe AC-I-23-0194 Bordi apjvoi kërkesën e palës për rishqyrtim të vendimit Nr.Ref. BD-175/16 të datës 27.01.2023 dhe po ashtu aprovoi rivlerësimin e shumës së qirasë kryesore në bazë të çmimit të përcaktuar nga ana e Komisionit vlerësues.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/39

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Nenit 10.1.4 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet këkesa për qiradhënie direkte për ngastrën kadastrale nr. 00001-1 ZK Koxhaj për pronën e NSh Zadruga Shtërpce GJI033, me sipërfaqe prej 3515 m² për parashtruesin e kërkesës Simtex Sh.P.K. përfaqësuar nga Reshad Cej sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 163.27 €/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Me datë 28.10.2024 Zyra Qendrore e AKP-së ka pranuar kërkesën me numër protokollit 4553 nga Simtex Sh.P.K. përfaqësuar nga Reshad Cej i cili ka shprehur interes të marr me qira asetin e lartpërmendur për të montuar impiantin e ujërave të zeza.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 472/2024 të Drejtorit Ekzekutiv ka bërë përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për ngastrën kadastrale nr. 00001-1 ZK Koxhaj në sipërfaqe prej 3515 m² është në shumën prej 163.27 €/muaj. Pala ka siguruar letër mbështetëse nga ana e autoriteteve lokale të KK Kaçanik, mbështetje kjo e argumentuar me faktin se qiramarrja/ndërtimi i implantit në këtë rast do të ndikonte në mbrojtjen e ambientit dhe ndikimit në mjedis.

Duke qenë se mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së NSh-ve dhe me qëllim të gjenerimit dhe rritjen e të hyrave të NSh-ve këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht tek Buxheti të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/40

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Nenit 10.1.4 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, nenit 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirim të asetëve të NSh-ve nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte për pjesë të ngastrës kadastrale nr. 00521-0 ZK Ferizaj për pronën e NSh Plantacioni i Pemëve, GJI012, me sipërfaqe prej 20 m² për parashtruesin e kërkesës Bujar Bytyqi sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 120.00 €/muaj.
- II. Para lidhjes së marrdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive, duke e llogaritur nga muaji tetor dhe nëntor 2024, palës Bujar Bytyqi do i kërkohet të paguajë retroaktivisht shumën prej 240.00 € para nënshkrimit të kontratës së qirasë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Me datë 31.10.2024 ZR Gjilani ka pranuar kërkesën me numër protokollit 14542/24-IN nga pala Bujar Bytyqi për qiramarrje për kioskën të cilën e përdor për shitjen e prodhimeve bujqësore të cilën tanimë e ka vendosur me pëlqimin e KK Ferizaj. Sipas palës këtë kioskë e ka vendosur disa ditë më herët në bazë të pëlqimit/vendimit të dhënë nga KK Ferizaj i cili është lëshuar më datë 09.10.2024 dhe nuk ka qenë në dijeni se i duhet edhe pëlqimi i AKP-së derisa një gjë e tillë është përcaktuar në vendimin e Komunës.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 468/2024 të Drejtorit Ekzekutiv ka bërë përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për pjesë të ngastrës kadastrale nr. 00521-0 ZK Ferizaj në sipërfaqe prej 20 m² është në shumën prej 120.00 Euro/muaj. Pala ka siguruar letër mbështetëse/vendim nga KK Ferizaj, mbështetje kjo e argumentuar me faktin se qiramarrja në këtë rast do të ndikonte në zhvillimin e aktivitetit biznesor të palës për shitjen e produkteve bujqësore.

Agjencia konstaton se si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën nga data kur secili ka hyrë në shfrytëzim të këtyre hapësirave. Andaj, nga pala të kërkohet që para nënshkrimit të kontratës të paguaj shumën e qirasë në mënyrë retroaktive nga data 01.10.2024 për arsye se i njëjti deklaron se e ka vendosur kioskën disa ditë para dhënies së pëlqimit për vendosje nga KK Ferizaj (09.10.2024). Kështu që palës Bujar Bytyqi për shfrytëzimin e pjesës prej 20 m² nga ngastra kadastrale 00521-0 ZK Ferizaj t'i kërkohet të paguajë retroaktivisht shumën prej 120.00 € (120.00 € X 2 muaj (tetor, nëntor 2024) = 240.00 €).

Duke qenë se mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së NSh-ve dhe me qëllim të gjenerimit dhe rritjen e të hyrave të NSh-ve këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe



përfundimisht tek Buxheti të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/41

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 të Ligjit, Nenit 10.1.8 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte të lokalit afarist UNIVERZAL në Mitrovicën e Veriut për pronën e NSh Lux MIT039, në sipërfaqe prej 36.00 m2 për Galib Dedovic sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 108.00 €/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Më datë 19.08.2024 është pranuar kërkesa nga Galib Dedovic për qiramarrjen e lokalit afarist UNIVERZAL me sipërfaqe prej 36.00 m2 e cila gjendet në rrugën Kral Petar I pn, Mitrovicë e Veriut.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 443/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalin afarist me sipërfaqe prej 36.00 m2 e cila gjendet në Mitrovicën Veriore është në shumën prej 108.00 €/muaj.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 443/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalin afarist me sipërfaqe prej 36.00 m2 e cila gjendet në Mitrovicën Veriore është në shumën prej 108.00 €/muaj.


Duke qenë se mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së NSh-ve dhe me qëllim të gjenerimit dhe rritjen e të hyrave të NSh-ve këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht tek Buxheti të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.


Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/42

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 të Ligjit, Nenit 10.1.4 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte të lokalit afarist në Leposaviq me sipërfaqe prej 69.2 m2 për pronën e NSh Jugobanka-MIT101, për personin fizik Rahim Pacolli sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 160.00 €/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Më datë 14.10.2024 është pranuar kërkesa nga ana e personit fizik Rrahim Pacolli për qiramarrjen e një pjesë të hapësirës së lokalit afarist me sipërfaqe prej 69.2 m2 e cila gjendet në Rr. Ish-APJ pn, Leposaviq.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 445/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, matjen e saktë të sipërfaqes, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalin afarist me sipërfaqe prej 69.2 m2 e cila gjendet në Leposaviq është në shumën prej 160.00 €/muaj.

Për pjesën e shfrytëzimit të mëmparshëm, Autoriteti i Likuidimit do të parashtrijë padi për shfrytëzim të paligjshëm dhe pasurim të pabazë ndaj Jugobanka Sh.A. dhe Banka Poshtanska Shtedionica Sh.A. të dyja struktura paralele).

Duke qenë se mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së NSh-ve dhe me qëllim të gjenerimit dhe rritjen e të hyrave të NSh-ve këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht tek Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/43

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 të Ligjit, Nenit 10.1.8 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte të lokalit afarist në Leposaviq me sipërfaqe prej 44.1 m² për pronën e NSh Jugobanka-MIT101, për personin fizik Ivan Ackovic sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 110.00 €/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Me datë 26.07.2024 është pranuar kërkesa nga ana e personit fizik Ivan Ackovic për qiramarrjen e një pjesë të hapësirës së lokalit afarist me sipërfaqe prej 44.1 m² e cila gjendet në Rr. Ish-APJ pn, Leposaviq.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 476/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, matjen e saktë të sipërfaqes, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalit afarist me sipërfaqe prej 44.1 m² e cila gjendet në Leposaviq është në shumën prej 110.00 €/muaj.

Duke qenë se mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së NSh-ve dhe me qëllim të gjenerimit dhe rritjen e të hyrave të NSh-ve këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht tek Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/44

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 të Ligjit, Nenit 10.1.8 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte të lokalit afarist në Leposaviq me sipërfaqe prej 45.2 m² për pronën e NSh Jugobanka-MIT101, për personin fizik Dragica Ivanovic sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 110.0 €/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Me datë 26.07.2024 është pranuar kërkesa nga ana e personit fizik Dragica Ivanovic për qiramarrjen e një pjesë të hapësirës së lokalit afarist me sipërfaqe prej 45.2 m² e cila gjendet në Rr. Ish-APJ pn, Leposaviq. Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 475/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, matjen e saktë të sipërfaqes, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalin afarist me sipërfaqe prej 45.2 m² e cila gjendet në Leposaviq është në shumën prej 110.0 Euro/muaj. Për pjesën e shfrytëzimit të mëparshëm, Autoriteti i Likuidimit do të parashtrojë padi për shfrytëzim të paligjshëm dhe pasurim të pabazë ndaj Jugobanka Sh.A. dhe Banka Poshtanska Shtedionica Sh.A - të dyja struktura paralele.

Duke qenë se mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së NSh-ve dhe me qëllim të gjenerimit dhe rritjen e të hyrave të NSh-ve këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht tek Buxheti të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.


Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/45

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 3 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, t.3.10.1 të Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, neni 6.2 dhe 7 i kontratave të qirasë me nr. protokollin 37710/të 4-OUT dhe 37711/24-OUT, neni 590 par. 1 dhe 595 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e qiramarrësit Visar Miftari për kthimin e mjeteve të paguara në shumën prej 4,000.00 Euro në emër të kontratave të qirasë me nr. protokollin 37710/24-OUT dhe 37711/24-OUT të lidhura për qiradhënien e ngastrave kadastrale 00426-1 dhe 00438-1 ZK Sadovinë e Jerlive, Viti më datë 22.07.2024 për pronën e NSH Agromorava.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kthimit të mjeteve sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Pala Visar Miftari ka hyrë në marrdhënie kontraktuale të qirasë pas tenderit publik të mbajtur më datë 07.06.2024, ku i njëjti ka ofertuar në dy njësi:

Njësinë nr. 12 – Ngastra kadastrale 00438-1 ZK Sadovinë e Jerlive, Viti në sipërfaqe prej 139081 m2 me kulturë tokë bujqësore, ku ka ofertuar shumën prej 5,000.00 Euro; dhe

Njësinë nr. 13 – Ngastra kadastrale 00426-1 ZK Sadovinë e Jerlive, Viti në sipërfaqe prej 202700 m2 me kulturë tokë bujqësore, ku ka ofertuar shumën prej 7,000.00 Euro.

Duke qenë se kishte dy kontrata të qirasë në shuma relativisht të larta dhe pas kërkesës së palës, Autoriteti i Likuidimit i kishte dhënë pëlqimin që pagesa të kryhet më këste, ashtu që pala të paguajë në tri këste nga 4,000.00 Euro. Pala pagesën e njërit këst e ka përfunduar.

Pala tani gjatë sezoni sipas deklaratës së tij, ka shkuar për të punuar tokën dhe nuk ka mundur ta punojë për arsye se aty është ndeshur me disa qytetarë të cilët pretendojnë që këtë pronë e shfrytëzojnë që nga viti 1999 dhe nuk i kanë lejuar qasje qiramarrësit për të shfrytëzuar parcelën sipas kontratave të qirasë.

Pala pastaj ka paraqitur ankesë se përse prona i është lëshuar me qira në këtë formë duke qenë se e punon dikush tjetër dhe poashtu pretendon që rastin e ka paraqitur edhe në Polici, por nga Policia janë deklaruar se ata mund të dalin në terren vetëm gjatë kohës që palët gjinden në këto parcela duke e punuar tokën. Pala në shkresë poashtu ka kërkuar që përpos kthimit të mjeteve të bëhet edhe ndërprerjen e këtyre kontratave të qirasë.

Në bazë të informatave nga ZR Gjilan, disa vite më parë të dy këto ngastra kanë qenë të ofertuara për shitje përmes tenderit publik, mirëpo për shkak të pengesave nga fshatarët tenderi është prishur dhe një numër i fshatarëve janë arrestuar nga Policia e Kosovës.

Bordi konsideron se duke qenë se tek kjo situatë ka ardhur pa fajin e qiramarrësit, atëherë është e arsyeshme që të aprovohet kërkesa për kthimin e mjeteve nga llogaria e NSH-së në llogarinë e qiramarrësit.



Poashtu, edhe në kontratën e qirasë, saktësisht në nenin 7 parashihet e drejta e qiramarrësit në shfrytëzim pa pengesa të asetit të lëshuar me qira dhe poashtu edhe në nenin 6 par. 2 nënpar. b parashihet rastet e dështimit nga ana e qiradhënësit.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/46

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 3 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, neni 3.10.1 të Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, neni 7 të kontratës së qirasë me nr. protokollin 37710/24-OUT dhe 37711/24-OUT, neni 590 par. 1 dhe 595 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e qiramarrësit Agron Muçaku për kthimin e mjeteve të paguara në shumën prej 5,000.00 Euro në emër të kontratës së qirasë me nr. protokollin 1261-2023 e lidhur për qiradhënien e ngastrës kadastrale 00513-0 ZK Qerim më datë 25.08.2023 për pronën e NSh Ereniku Prodhimtaria Primare PEJ029.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kthimit të mjeteve sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Pala Agron Muçaku ka hyrë në marrdhënie kontraktuale të qirasë më datë 25.08.2023 në bazë të kontratës së qirasë me nr. protokollin 1261/2023 për ngastrën kadastrale 00513-2 ZK Qerim në sipërfaqe prej 7631 m² për shfrytëzim për kultivimin e prodhimeve bujqësore. I njëjti nuk ka mundur dhe poashtu konfirmimit nga ZR Pejë të hyjë në shfrytëzim të kësaj ngastre për shkak se kjo ngastër shfrytëzohej kundërligjshëm, nga tanimë personi i njohur ndaj të cilit Autoriteti i Likuidimit ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore.

Para nënshkrimit të kontratës së qirasë i njëjti është paraqitur në ZR Pejë dhe ka deklaruar se që nga momenti që ka marrë pjesë në tender më datë 28.07.2023 është duke u përcjellë nga disa persona të panjohur.

Më datë 17.08.2023 është bërë vizita në terren për parcelën në fjalë dhe është indentifikuar shfrytëzuesi i paligjshëm, Genc Pozhegu. Më datë 18.08.2023 është denoncuar rasti në Stacionin Policor në Gjakovë si dhe në inspektoriatin e ndërtimit të KK Gjakovë

Më datë 22.08.2023 është pranuar përgjigjja nga Inspektoriati i KK Gjakovë dhe në përgjigje është bashkëngjitur Aktvendimi i Komisionit për Komosacion ku parcela 513-2 dhe 516-1 kanë marrë numër të ri dhe janë bartur në pronësi të Kompanisë Stella Sh.P.K. me pronar Genc Pozhegu. Më datë 29.08.2023 është parashtruar padi në DhPGJSK kundër Stella Sh.P.K. në pronësi të Genc Pozhegu për pengim posedim.

Në vijim i janë dërguar shkresa Kryetarit të KK Gjakovë dhe Drejtorisë së Kadastrit të KK Gjakovë në lidhje me zbatimin e vendimeve të Komosacionit. Me datë 10.10.2023 kemi pranuar shkresë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ku deklarohet se Aktvendimi i Zyrës Kadastrale KK Gjakovë për Komosacion 11/72 i dt. 20.06.2022 është i kundërligjshëm për arsye se është nxjerrë në bazë të ligjit që nuk është në fuqi.

Më datë 16.09.2024 kemi pranuar Aktvendimin CN-23-0007 ku është aprovuar kërkesëpadija si e bazuar dhe është konstatuar se e paditura Stella Sh.P.K është duke e penguar paditësen në posedim dhe është obliguar e paditura që të bëjë kthimin në gjendjen e mëmparshme.



Për më tepër, qiramarrësi kërkon përpos kthimin e mjeteve edhe ndërprerjen e këtyre kontratave të qirasë. Aktualisht, kontrata e qirasë ka skaduar dhe pala nuk ka kontratë aktive të qirasë.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/47

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen mbajtur me datë 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Apropohet kërkesa për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN048 NSh Energoinvest (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës me një (1) kreditor të përfshirë, në shumën totale prej 4,695.00 €.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim të Shpërndarjes së Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN048 NSh Energoinvest (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes së Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN048 NSh Energoinvest (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/48

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen mbajtur me datë 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për tre (3) kreditorë të përfshirë të NSh "N.T.Sh. Tregtia" GJI097 (në likuidim) nga Rajoni i Ferizajit në shumën totale prej 21,153.73 €.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim të Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh "N.T.Sh. Tregtia" GJI097 (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh "N.T.Sh. Tregtia" GJI097 (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/49

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen mbajtur me datë 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet kërkesa për korrigjim të raportit të shpërndarjes plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PEJ130 NSH NHT Rugova (në likuidim) nga Rajoni i Pejës në shumën totale prej 4,640.00 Euro dhe ndryshohet vendimi i Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-213/20 i datës 30.10.2024.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim të raportit korigjues të shpërndarjes së plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e PEJ130 NSH NHT Rugova (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.

Në raportin e shpërndarjes së përkohshme plotësuese të paraqitur me 30 tetor 2024, kreditorët, kërkesat e të cilëve janë aprovuar në bazë të vendimeve të plotfuqishme të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme janë paraqitur për pagesë në shumat e aprovuara si Neto dhe jo si Bruto siç do të duhet të paraqiteshin.

Në raportin e shpërndarjes së përkohshme të paraqitur në tetor 2016 e të aprovuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-82/17 dhe me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-186/29 të datës 31 gusht 2023 të raportit të shpërndarjes plotësuese nuk ishin të përfshirë tre kreditorët që janë të përfshirë në shtojcën 3 të këtij raporti të shpërndarjes, për arsye se kishin parashtruar ankesa në DhPGJSK ndërsa në ndërkohe DHPGJS ka vendosur mbi ankesat e tyre dhe palën disa herë kanë parashtruar kërkesë që të ekzekutohen vendimet e Autoritetit të Likuidimit, përkatësisht Akgjykimet e Kolegjit të Apelit të DhPGJ-së. Në raportin e tanishëm për pagesë janë total 4,640.00 Euro në vend të shumës 4,938.13 Euro sa ishte me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-213/20 të datës 30 tetor 2024.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-215/50

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregullores Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Nenit 42 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore Ligji Nr. 2003/11 për Rrugët, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 nëntor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aseti siç përshkruhet në certifikatën e pronësisë me nr.P-70705005-00775-8 ZK Bec me sipërfaqe totale prej 542 m2 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet pronë e NSh "KB Beci" PEJ003.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, këto asete do të kalojnë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aseti respektivisht nga prona e NSh "KB Beci" PEJ003 sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se ngastra kadastrale P-70705005-00775-8 ZK Bec që është objekt i kësaj kërkesë sipas gjendjes faktike është evidentuar si rrugë, e cila shërben për lëvizjen e qytetarëve, është rrugë e pa asfaltuar e cila është rrugë e lagjes dhe rruga brenda oborrit të xhamisë, ndërsa sipas certifikatës së pronësisë evidentohet me kulturë bujqësore-kullosë e klasës së tretë. Në këtë rast duke qenë se kategorizohet si rrugë, duke pasur parasysh edhe nenin 6 par.2 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, në të cilin parashihet që "rrugët publike mund të jenë të destinuara për pjesëmarrës në komunikacionin rrugor (për automjete motorike, biçikleta, këmbësorë dhe shfrytëzues të tjerë), ose vetëm për automjete motorike".

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët "asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjesë të rrugës publike". Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së asetëve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi-pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 nëntor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues/
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit